

**HAREDIN XHAFERI****LOKUCIONE NDAJFOLJORE ME STRUKTURË DYFJALËSHE**

Sot është i njohur kuptimi i termit “lokucion” si grup fjalësh me lidhje të qëndrueshme, i barazvlershëm me fjalën kuptimisht dhe gramatikusht, por jo i njëjtë me të.<sup>1</sup> Duhet mbajtur parasysh se lokucionet, të cilatdo lloji qofshin, nuk janë fjalë, por toje fjalësh ose togfjalësha të qëndrueshëm. Si të tilla, ato as nuk duhen analizuar bashkë me fjalët, as nuk duhen përfshirë në shembuj ilustrues së bashku me to. Gjithashtu, këto njësi duhen dalluar qartë edhe nga njësitë frazeologjike. M. Domi e ka shtruar kohë më parë nevojën e njohjes së tyre si njësi gjuhësore më vete.<sup>2</sup> Meqë lokucionet nuk janë fjalë, termi “fjalëformim” nuk na duket i përshtatshëm për t’u përdorur gjatë analizës së formimit të tyre.

Me lokucionet, si njësi leksikore dhe gramatikore, lidhen një sërë çështjesh që kërkojnë një trajtim më të plotë. Me rëndësi është përcaktimi i vendit që duhet të zënë ato në një disiplinë të caktuar gjuhësore; trajtimi i tyre si njësi gjuhësore të veçanta, duke përcaktuar qartë kriteret e studimit; evidentimi i plotë i veçorive dhe tipareve më të përgjithshme, si njësi gjuhësore më vete, si dhe i veçorive të llojeve e nënlojeve të tyre; përcaktimi sa më i saktë i veçorive që i bashkojnë dhe që ndajnë nga njësitë e tjera në kufi me to; identifikimi sa më i plotë i elementeve që përbëjnë strukturën e tyre dhe, në mënyrë të veçantë, përcaktimi i shkallës së qëndrueshmërisë së këtyre elementeve brenda strukturës së lokucionit etj.

Fjalët, që përbëjnë lokucionet, e kanë humbur, diku më pak e diku më shumë, kuptimin dhe mëvetësinë e tyre. Shkalla e shkuptimësimit të këtyre fjalëve është e ndryshme dhe shërben si një nga kriteret kryesore për dallimin e lokucionit nga togu i lirë. Lokucionet nuk kanë kuptim emocional, i cili është karakteristik për njësitë frazeologjike.<sup>3</sup> Ato mund të kenë kuptim të figurshëm ose të drejtpërdrejtë.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, 1995, f. 39.

<sup>2</sup> M. Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, Studime filologjike, 1, 1985, f. 214.

<sup>3</sup> J. Thomai në hyrjen e fjalorit frazeologjik (1999) e veçon ekspresivitetin si një nga tiparet më specifike dhe më thelbësore të frazeologjisë (f. 13), ndërsa në tekstin “*Leksikologjia e gjuhës shqipe*,” 2011 nuk e merr si karakteristikë të qenësishme të njësive frazeologjike, kur shkruan: “Në shumë raste njësitë frazeologjike kanë ngjyrim emocional” (f. 212).

<sup>4</sup> Më gjerë për vërejtjet e mësipërme shih *Për lokucionet në gjuhën shqipe*, Malësia, nr. 8, Podgoricë, 2013, f. 107 - 110.

Lokucionet me vlerë ndajfoljeje janë struktura të formuara nga fjalë me veçori leksiko - gramatikore të ndryshme dhe me shkallë qëndrueshmërie të ndryshme. Këto bashkime të qëndrueshme kuptimisht janë të barazvlershme me një ndajfolje dhe kryejnë funksion sintaksor të njëjtë me të. Ato karakterizohen nga kuptimi i vetëm (i drejtpërdrejtë ose i figurshëm), nga mungesa e ngjyrimit a ngjytimeve kuptimore, nga shkalla e ngurosjes së elementeve përbërëse, nga mungesa e motivimit, nga mungesa në disa raste e fjalëve kuptimplota<sup>5</sup> në strukturën e tyre etj.

Ky grup lokucionesh është më i trajtuar se grupet e tjera në gramatika të ndryshme dhe në studime të autorëve të veçantë, si nga ana semantike, dhe nga ana strukturore.

Që në gramatikat e hershme të shqipes janë pasqyruar struktura të ndryshme me vlerë ndajfoljeje.<sup>6</sup>

A. Xhuvani këto lokucione i ka trajtuar veçmas, duke pasqyruar pak grupe të formuara nga një parafjalë dhe një emër, një mbiemër a ndajfolje ose me përsëritjen e një emri (të lidhur me vizë) a të një ndajfoljeje (të lidhur me lidhëz).<sup>7</sup>

Sh. Demiraj në një studim të veçantë ka trajtuar në mënyrë të zgjeruar tri kushtet e kalimit të një forme emërore a foljore ose të një togu të tipit *parafjalë + emër* në ndajfolje: ndryshimet leksikore, duke u shndërruar në një njësi të re leksikore, me kuptim kategorial të ri; ndryshimet gramatikore, duke marrë tipare gramatikore karakteristike për ndajfoljet; mungesa e kufizimit funksional, përdorimi si ndajfolje në një numër gjithnjë e më të madh rastesh.<sup>8</sup> Pasi ka dhënë përkufizimin e lokucionit ndajfoljor, autori strukturat e formuara nga *parafjalë + emër*, i quan lokucione, kur pjesët përbërëse të këtyre strukturave janë shndërruar në një njësi të pandashme si kuptimisht dhe

<sup>5</sup> Termi “*fjalë kuptimplote*” është marrë nga *Gramatika ...*, I, vep. e cit. f. 38.

<sup>6</sup> Këtu do të përmendim pasqyrimin e lokucioneve në disa gramatika të shqipes të hartuara nga Rilindja deri në fund të gjysmës së parë të shekullit të kaluar. Shembujt e sjellë në këto gramatika jo në çdo rast janë lokucione. Kjo vjen nga paqartësia rreth konceptit mbi lokucionin në përgjithësi dhe atë ndajfoljor në veçanti. Kështu, S. Frashëri merr si ndajfolje edhe togje të tipit *në mëngjest* (*Shkronjëto e gjuhësë shqip*, Bukuresht, 1886, f. 130); O. Myderrizi quan të tilla edhe togjet e tipit *pa kujdes* (*Gramatika e re e shqipes*, Tiranë, 1944, f. 273); K. Cipoja quan ndajfolje (lokucion) togfjalëshat e lirë *para tri ditësh, gjithë ditën, tërë natën* etj. apo *nga çdo anë, mb' at - anë, mbë çdo anë* etj. (*Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, f. 180, 181). Një gjë e tillë vihet re edhe në disa studime të mëvonshme.

<sup>7</sup> A. Xhuvani, *Orgjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipe*, Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II, 1975, f. 197 – 198.

<sup>8</sup> Sh. Demiraj, *Rreth ndajfoljzimit (adverbializimit) të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë + emër*, Çështje të fonetikës dhe të gramatikës ..., vep. e cit., f. 70 – 73.

gramatikisht, duke marrë vlerën dhe tiparet e një ndajfoljeje.<sup>9</sup> Në artikull ai pasqyron edhe disa togje *para-fjalë + emër*, si: *nga herë, nga ditë, nga mot, me të keq, me të mirë, me të egër, me të madhe, me të qeshur* etj., për të cilat mendon se duhen marrë si lokucione ndajfoljore.<sup>10</sup>

E. Hysa në studimin për formimin e ndajfoljeve ka pasqyruar edhe mjaft grupe lokucionesh sipas strukturës.<sup>11</sup> Sikurse A. Xhuvani, ky autor strukturat e formuara nga përsëritja e së njëjtës fjale, të lidhura me vizë lidhëse, i ka trajtuar si lokucione.<sup>12</sup> Këtë qëndrim e ka mbajtur edhe më pas.<sup>13</sup> Në FGJSSH këto struktura janë pasqyruar me shënimin *ndajf.*, pra, si një fjalë. Të tilla i kanë quajtur edhe studiues të tjerë.<sup>14</sup>

Në dy veprat akademike “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe”, II dhe “Gramatika e gjuhës shqipe”, I këto njësi janë trajtuar më gjerësisht, por edhe në këto vepra ato janë trajtuar bashkë me ndajfoljet.

Lokucionet ndajfoljore përbëjnë sot një grup mjaft të pasur. Ato paraqiten të larmishme nga kuptimi dhe nga struktura. Një trajtim i përgjithshëm i tyre i kapërcen caqet e një artikulli. Objekti i këtij shkrimi është trajtimi i mënyrave të formimit të lokucioneve me strukturë dyfjalëshe, si një grup i veçantë, duke pasqyruar edhe marrëdhëniet semantike që ato shprehin. Formimi i tyre nuk është trajtuar gjerësisht në ndonjë studim të veçantë. Kjo më shërbeu si motiv për t’i trajtuar këto njësi gjuhësore, në këtë aspekt. Në këtë shkrim do të bëhet një trajtim më specifik dhe më i hollësishëm i grupeve dhe nëngrupeve që përbëjnë këto njësi, do të pasqyrohet larmishmëria e tyre strukturore dhe semantike, do të bëhen përpjekje për të veçuar rastet kur një strukturë e caktuar ka kaluar nga tog i lirë në lokucion dhe nga lokucion drejt një fjale të përngjitur. Duke u bazuar në tiparin e lidhjes së qëndrueshme të elementeve përbërëse dhe në ndryshimet kuptimore dhe gramatikore të këtyre elementeve, do të synohet për një përcaktim më të saktë të këtyre njësisive, krahasuar edhe me trajtimet e deritanishme.

<sup>9</sup> Po aty, f. 74.

<sup>10</sup> Po aty, f. 75 – 77.

<sup>11</sup> E. Hysa, *Formimi i ndajfoljeve*, Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, 1972, f. 296 – 305.

<sup>12</sup> Po aty, f. 296.

<sup>13</sup> Shih *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, 1976, f. 330 dhe *Gramatika ...*, I, vep. e cit. Në veprën e fundit ato janë quajtur njësi të lidhura për nga orgjina me lokucionet ndajfoljore, pasi “kanë marrë tipare fjalësh të përbëra.” (f. 378).

<sup>14</sup> Shih A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe,”* Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, 1972, f. 35; A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, Çështje të gramatikës ..., vep. e cit., f. 179; *Fonetika dhe gramatika ...*, vep. e cit., f. 163; *Gramatika ...*, I, vep. e cit., f. 378.

Lokucionet ndajfoljore me strukturë dyfjalëshe janë formuar nga fjalë me veçori leksiko - gramatikore të njëjta ose të ndryshme dhe shprehin marrëdhënie rrethore a rrethore - përcaktore. Këto lokucione janë të përbëra nga dy fjalë kuptimplota ose nga një fjalë jokuptimplotë dhe një fjalë kuptimplotë.

### I. Lokucionet e formuara nga dy fjalë kuptimplota

Ky grup lokucionesh nuk përbën numër të madh. Këto lokucioneve në strukturën e tyre kanë dy fjalë me veçori leksiko - gramatikore të njëjta ose të ndryshme.

#### 1. Lokucione të formuara nga një fjalë emërore<sup>15</sup> dhe një emër

Në këtë grup dallohen lokucione të formuara nga një *përemër* dhe një *emër* ose nga një *numëror* dhe një *emër*.

**a.** Lokucione të formuara nga një *përemër* dhe një *emër*. Këto lokucione gjytmtyrë të parë kanë një *përemër* të pacaktuar. Nëpërmjet tyre shprehen marrëdhënie semantike të ndryshme.

- Lokucioni *pak gjë* është ndërtuar me *përemrin pak*, që tregon sasi të pacaktuar frymorësh, sendesh etj. dhe *emrin gjë*, me kuptim të përgjithësuar. Brenda lokucionit emri nuk mund të lidhet me përcaktues të tjerë. Lokucioni shpreh marrëdhënie sasiore të papërcaktuara. P.sh. - *Mos u mërzi, se kjo të kushton pak gjë, - i tha tjetri për ta qetësuar.*

- Me *përemrin* me kuptim mohues *asnjë* dhe një *emër* që emërton përgjithësisht një çast kohor të shkurtër, janë formuar strukturat *asnjë çast*, *asnjë moment*, *asnjë minutë*, *asnjë sekondë* etj. Këto struktura përdoren me kuptim të drejtpërdrejtë. Kuptimi leksikor i secilit element në këto struktura nuk ruhet. Secili prej tyre nuk i ruan lidhjet e veçanta me fjalët e tjera dhe struktura funksionon si një e tërë. Në rastet kur emri ndryshon sipas kategorive ose mund të hyjë në lidhje të veçanta me fjalë të ndryshme përcaktuese, këto struktura funksionojnë si togje të lira. P.sh. *Nuk gjeti asnjë çast* të përshtatshëm *për të biseduar me të atin*. Si lokucione ato përdoren kur sinonimizojnë me ndajfoljet *kurrë*, *asnjëherë*. P.sh. - *Ky s'm'u nda për asnjë çast, - tha Eva*. Përdorimi i parafjalës *për* para këtij lokucioni nuk është detyrimisht i domosdoshëm.

- Lokucioni *njëfarë kohe* është formuar nga *përemëri njëfarë* dhe emri *kohë* në rrjedhore të pashquar. Ka shkallë të lartë gramatikalizimi dhe është fare pranë njëfjalëzimit. P.sh. - *Çdo qytetar kalonte pranë tij dhe e vështronte pa lëvizur për njëfarë kohe.*

**b.** Lokucione të formuara nga një *numëror* dhe një *emër*. Në këtë mënyrë janë formuar pak lokucione.

<sup>15</sup> Të tilla janë fjalët që kanë kategori gramatikore si të emrit (mbiemrat, përemrat, numërorët).

• Lokucionet *një çikë, një grimë, një fije* etj. tregojnë masën e veprimit. Në FGJSSH fjalët *çikë, grimë dhe fije* janë pasqyruar si emra. Për dy emrat e parë është pasqyruar edhe përdorimi ndajfoljor i tyre f. 260, 574). Një nga kuptimet e emrit *grimë* është sqaruar me strukturën *një fije*. Edhe lokucioni *për një fije* është sjellë si sinonim i lokucionit *për një çikë* (f. 260). Me vlerë ndajfoljeje këta emra përdoren vetëm të paraprirë nga numërori *një*. Në strukturën e lokucionit ky numëror është desemantizuar plotësisht. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me emrat. Kur këto struktura janë barazvlerëse me ndajfoljen *pak*, në strukturën e tyre nuk mund të ndryshohet numërori, ndërsa me emrin nuk mund të krijohen lidhje të reja. Ata funksionojnë si tërësi e vetme, e cila po shkon drejt gramatikalizimit të plotë, drejt njëfjalëzimit. P.sh. *Beshua mbeti në divan. Ndenji një çikë më këmbë, pastaj u ul në një karrige afër dritares. - Mundet, mundet, - pranova dhe vazhdova ta vështroja në mënyrë kërkuese. - Pe një grimë vetveten dhe me vetveten qeshët njësoj të dy bashkë*. Mendojmë se me përemrin *asnjë* në strukturë këto njësi duhen përdorur si fjalë të përngjitura: *asnjëçikë, asnjëgrimë, asnjëfije*, njëlloj si përemri *asnjëfarë*.<sup>16</sup> Këtë e përligj edhe përdorimi i theksit, zakonisht vetëm te fjala e dytë.

• Lokucionet *një ditë, një natë, një mbrëmje, një mëngjes* etj.<sup>17</sup> janë formuar nga numërori *një* dhe një emër që emërton një periudhë kohe të caktuar. Emri përdoret në rasën në kallëzore ose rrjedhore të pashquar. Këto struktura shprehin marrëdhënie kohore të papërcaktuara. Nga vlera semantike ato sinonimizojnë me ndajfoljet *dikur, njëherë*. P.sh. *Një ditë, një pronar që kishte nevojë për marinarë, e njohu Kristoforin dhe e mori me vete në një anije të madhe, e cila shpalosi velat drejt ishullit Shio*. Këto struktura dalin edhe me emrin në rrjedhore të pashquar: *një dite, një nate, një vere, një dimri, një mëngjesi* etj.

## II. Lokucionet e formuara nga një fjalë jokuptimplotë dhe një fjalë kuptimplotë

Lokucionet që përfshihen në këtë grup, janë të shumta. Fjala jokuptimplotë e këtyre strukturave është parafjalë, lidhëz ose pjesëz.

### 1. Lokucione të formuara nga një parafjalë dhe një fjalë kuptimplotë

Janë të shumëllojshme dhe përbëjnë një numër relativisht të madh. Elementi i parë në strukturën e këtyre njësisve është një parafjalë e një rase të caktuar. Elementi i dytë është emër. Klasifikimi i mëtejshëm i tyre do të bëhet sipas grupeve të parafjalëve.

<sup>16</sup> FGJSSH, f. 63.

<sup>17</sup> Në FGJSSH është pasqyruar vetëm struktura *një ditë* si tog me kuptimin e ndajfoljes *dikur*.

a. *Lokucione të formuara nga parafjalë të rasës emërore dhe një emër.* Nga parafjalët e rasës emërore është përdorur parafjala *nga*.<sup>18</sup> Me emrin *mot* kjo parafjalë ka formuar lokucionin *nga mot* (përherë, ngaherë),<sup>19</sup> i cili tregon kohë të papërcaktuar dhe të pakufizuar. P.sh. - ***Nga mot*** *gëzuar!* - *uroi plaku dhe ngriti gotën.*

b. *Lokucione të formuara nga parafjalë të rasës kallëzore dhe një emër.* Nga parafjalët e kësaj rase si elemente të lokucioneve janë: *për, me, më, në, nën, nëpër, pa.*

• Parafjala *për* del te një numër relativisht i madh lokucionesh. Ajo është lidhur me një emër vendi, me një emër kohe, me një emër abstrakt me orgjinë mbiemërore, me një ndajfolje, me një numëror, si dhe me emra të tjerë abstraktë me kuptime të ndryshme.

- Lokucionet *për truall, për tokë, për dhe, për qiell* (lart) janë formuar nga parafjala *për* dhe një emër vendi.<sup>20</sup> Marrëdhëniet që shprehin këto lokucione, janë hapsinore të papërcaktuara. P.sh. *Si tha këto, rrahu këmbët për truall dhe s'luajti andej.* - *Ku ka mbetur ndonjë vend ? - pyeti brigadieri.* - *Asgjëkund. Do të flerë për tokë. Me t'u afruar aq pranë, sa të kishin mundësi të qëllonin njëri - tjetrin me shqelm, u ngritën mbi këmbët e pasme ... e pastaj duke shfryrë për qiell, nisën të godisnin shoku - shokun me thundrat tokmak.*

- Lokucionet *për jetë, për mot, për vit* (vazhdimisht) etj. kanë fjalë kuptimplotë një emër kohe të ngurosur. Këto struktura kanë fituar tiparet e ndajfoljes, dhe duhen trajtuar si të tilla, sikurse lokucionet *për natë, për ditë*.<sup>21</sup> Nëpërmjet tyre shprehen marrëdhënie kohore. *Arën përtej lumit e mbillnin për vit me perime.* - *Dëshirojmë që kjo miqësi të vazhdojë për jetë,* - *tha Samiu.*

<sup>18</sup> Sh. Demiraj këtë parafjalë e quan “fjalëz me orgjinë parafoljore,” e afërt me përemrin e pakufishëm *çdo* (*Rreth ndajfoljësimit ...*, art. i cit., f. 75 - 76). Në FGJSSH (f. 1238) është pasqyruar një kuptim kohor i përafërt i kësaj parafjale, kur lidhet me një emër kohe, si: *verë, mesnatë* etj. Elementet përbërëse të këto struktura ruajnë kuptimet e tyre. Megjithatë, ato kanë marrë edhe tipare të lokucionit dhe përdoren në disa raste si të tilla, për të shprehur marrëdhënie kohore të papërcaktuara, si: *nga java, nga vjeshta, nga dimri* etj. P.sh. *Kishte menduar të shkonte nga vjeshta për disa ditë në qytet te disa të afërm të saj.*

<sup>19</sup> Ky lokucion sot tingëllon më tepër si një fjalë (ndajfolje), sikurse ndajfolja *ngaherë*. Elementet përbërëse të tij shqiptohen pa pauzë. Parafjala *nga* nuk i ruan tiparet dhe funksionin e saj.

<sup>20</sup> Në fjalorët e gjuhës shqipe, tri njësitë e para janë pasqyruar si një fjalë e vetme. I tillë duhet trajtuar edhe lokucioni *për qiell*.

<sup>21</sup> Këto lokucione në FGJSSH janë paraqitur të njëfjalëzuara (f. 1425, 1453).

- Me një emër me orgjinë nga mbiemra të substantivuar<sup>22</sup> janë formuar lokucionet *për së mbari* (mbarë), *për së gjati*, *për së gjeri*, *për së larti*, *për së largu*, *për së tejmi*, *për së kthjellti*, *për së buti*, *për së forti*, *për së thati*, *për së njomi*, *për së gjalli*, *për së dyti*, *për së treti* etj. Marrëdhëniet semantike që shprehin këto lokucione, janë të ndryshme (vendi, mënyre etj.). P.sh. *Ja se çfarë lexojnë këtu. Libra çifutësh. Dhe duke u kthyer nga Shtenvijku i tha: - Bëni pra disa hapa për së gjati e për së gjeri! Ne kishim mbetur pa gojë, pa mend, si të shituar prej një gjëme rrufeje për së kthjellti. Ai trup, i parë për së larti, siç po e shikonte vajza, ishte me të vërtetë qesharak. - Pusho, de! Mos e qaj për së gjalli!... - tha një zë. Kështu arriti për së dyti te gryka e Shkumbinit. Shkalla e ngurosjes së elementeve të këtyre strukturave është e ulët. Gjymtyra emërore e disave prej tyre përdoret edhe pa parafjalën për (së larti, së gjati, së kthjellti etj.), duke shprehur atë marrëdhënie që shpreh lokucioni.*

- Lokucionet *për keq*, *për mirë*, *për mbarë* etj. janë formuar nga parafjala *për* dhe një ndajfolje përcaktore mënyre. Janë struktura me qëndrueshmëri të ulët dhe tregojnë kryesisht tipar. P.sh. - *Mos e merr jetën kaq lehtë dhe me shkujdesje e shpërfillje! Ajo mund të marrë për mirë, por edhe për keq. Bien në sy për keq të takohet një kujdestar kuajsh me një vajzë fisnike.*

- Me parafjalën *për* dhe një numëror janë formuar lokucione që shprehin mënyrën e veprimit, si: *për dy*, *për tre*, *për katër* etj. P.sh. *Rreshtat tanë bashkoheshin kur rruga ngushtohej, por, sapo dilnim në rrugë të gjerë, ne rreshtoheshim për dy dhe vazhdonim marshimin. Këtyre lokucioneve u përgjigjen semantikisht ndajfoljet *dysh*, *tresh*, *katërsh*. Parafjala *për* nuk ruan asnjë nga kuptimet e saj dhe numërori ka përdorim të ngurosur.*

- Një grup lokucionesh janë formuar nga lidhja e parafjalës *për* me emra abstraktë me kuptime të ndryshme, kryesisht emra cilësie, si: *për qejf*, *për mrekulli*, *për bukuri*, *për të keq*, *për të mirë* etj. Elementet e këtyre lokucioneve kanë shkallë qëndrueshmërie të lartë. Këto lokucione shprehin mënyrë. P.sh. *Të pritur dhe të sajdisur për mrekulli, ne qëndruam deri në mesnatë në këtë shtëpi të ndërtuar mbi një shkëmb sipër detit. Më vjen t'ju kujtoj për të keq, - foli dhe ajo me një shqipe të kulluar.*

E. Hysa vëren se lokucionet e grupeve që kanë element të parë parafjalën *për*, kryesisht ato që tregojnë kohë (*për vit*, *për natë*, *për ditë* etj.),

<sup>22</sup> E. Hysa i quan formime me mbiemra të gjinisë asnjëse në rasën rrjedhore (*Formimi...*, art. i cit., f. 305). Sh. Demiraj i ka quajtur forma të ngurosur të rrjedhore së pashquar njëjës të mbiemrave dhe të rreshtorëve të substantivuar asnjëse (*Rreth ndajfoljësimit ...*, art. i cit., f. 72). Në FGJSSH nuk është mbajtur një qëndrim i vetëm për këto fjalë. Kështu, fjalët *larti* (së), *gjati* (së), *gjeri* (së) etj. janë pasqyruar me shënimin *ndajf.* (Shih përkatësisht në faqet 952, 604, 613) Në f. 1416 të kësaj vepre për kuptimin e 20<sup>-të</sup> të parafjalës *për* shkruhet se “Përdoret ... me emra asnjëse në rasën rrjedhore ...”

shkruhen shpesh si një fjalë e vetme (ndajfolje).<sup>23</sup> Këtë rrugë kanë ndjekur edhe lokucionet *për hundësh, për dhëmbësh, për thonjsh* etj.

• Parafjala *me* bashkë me një emër, kur ky i fundit ka marrë një kuptim tepër të përgjithshëm,<sup>24</sup> ka formuar togje të qëndrueshme. Me këtë parafjalë janë lidhur përgjithësisht emra abstraktë me kuptime të ndryshme, por edhe emra konkretë.

- Lokucionet *me vakt, me kohë* (prej kohësh), *me mëngjes, me ditë, me natë* (herët), *me vjet, me muaj, me orë* (gjatë, për shumë kohë)<sup>25</sup> janë formuar me parafjalën *me* dhe një emër që tregon një periudhë kohe. E gjithë struktura shpreh marrëdhënie kohore të papërcaktuara. Si parafjala, dhe emri e kanë humbur kuptimin leksikor. Emrat kanë humbur edhe aftësinë për t'u lidhur me fjalë të tjera dhe për t'u përcaktuar prej tyre. P.sh. *Ky shfytyrim, të cilin unë iu nënshtrova, u bë me kohë një nga tiparet më të shprehura të karakterit tim.* - *Duhej ta kisha bërë me vakt,* - *më tha,* - *megjithëse edhe tani s'është vonë. Megjithëse baresha nga Trokthi ishte nisur me natë, e bardhë dhe e ndritshme i qe dukur rruga e qëndisur nga shkëndijimet e pikave të vesës. Mbi tryezat u hapën sërishmi hartat e lundrimit, mbi të cilat qëndronin me orë vëllezërit Polo.*

- Me emra abstraktë me kuptim të ndryshëm parafjala *me* ka formuar lokucione që shprehin marrëdhënie mënyre, rrallë tipar, si: *me hata* (kobshëm), *me hir, me urtësi* (paqësisht), *me pahir* (dhunshëm), *me ngulm* (ngultas), *me nge* (ngadalë), *me radhë* (radhazi), *me masë* etj. P.sh. *Ai e pa me ngulm. I shikoj me radhë një e nga një dhe, meqë aty për aty nuk më bie në sy asnjë që s'e kam marrë nëpër duar dhe së paku shfletuar, më ndalet shikimi në mbrojtjen e Sokratit të Platonit.* - *Le të merremi vesh me urtësi.* - *Nuk mund të bëjmë përherë shaka. Edhe shakaja me masë,* - *bëri vërejtje Sabriu.*

- Lokucionet *me të fortë, me të rreptë, me të egër, me të keq* (egërsisht, dhunshëm); *me të butë, me të urtë, me të mirë* (butësisht, qetësisht); *me të shpejtë; me të drejtë* (drejtësisht), *me të madh, me të madhe* (fort, fuqishëm), *me të qeshur, me të qarë* etj. janë formuar nga parafjala *me* dhe një emër abstrakt i prejardhur nga një mbiemër cilësor.<sup>26</sup> P.sh. *Në fund të javës së tretë*

<sup>23</sup> E. Hysa, *Formimi ...*, art. i cit., f. 304.

<sup>24</sup> Një gjë të tillë e ka pohuar më parë E. Hysa (Shih *Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe*, Studime filologjike, 1, 1970, f. 37).

<sup>25</sup> Emri te disa nga këto lokucione, kur përdoret në shumës, mund të pasohet nga mbiemri me orgjinë përemërore *i tërë*. Ky i fundit është element strukturor jo i qëndrueshëm i këtyre lokucioneve. P.sh. *Qëllonte ndonjëherë që gjyshja ishte e nxehur nga ndonjë ndodhi në shtëpinë e bankierit dhe shante me orë të tëra. Ajo ndërtesë ishte përdorur me vite të tëra si zyrë avokatore nga plaku, i cili kishte rënë shumë.*

<sup>26</sup> Këto fjalë janë quajtur me emra të ndryshëm nga studiues të ndryshëm. A. Xhuvani pranon lokucione të formuara nga një parafjalë dhe gjinia asnjëse e mbiemrit që

*shirat u shtruan dhe qielli filloi të derdhej me të butë, natë e ditë, duke përmbytur fushën. Sa po e merrte gjumi, dëgjoi çapin e rëndë të infermierit të ecë me të shpejtë e pastaj të trokasë në portën e tij. ... ka ngjarë që dikush ta quajë hero e dikush qyqar, dikush martir e dikush të dënuar me të drejtë, dikush orator e dikush demagog, dikush atdhetar e dikush, madje, tradhtar! Vjet të thamë me të urtë t'ia jepje këtë arë Kol Shpërvjelit, se nuk ia kishe fuqinë, se të vajti djali ushtar. Sillej rreth tyre e bërtiste me të madhe. - Secili të shkojë në punën e tij, - tha me të qeshur Jakup beu, porsa hyri në çadër.*

Emrat në këto struktura e kanë dobësuar kuptimin dhe i kanë humbur lidhjet sintaksore. Megjithatë, kuptimi i lokucionit del përgjithësisht nga përbërësi kuptimor kryesor i secilit prej tyre. Kështu, lokucioni *me të butë* dhe emri *butë (të)* kanë të përbashkët përbërësin kuptimor “butësi”. Ky lokucion sinonimizon me ndajfoljen *butësisht*. Këto lokucione kanë barazvlerëse një ndajfolje mënyre dhe shprehin atë marrëdhënie kuptimore që shpreh ndajfolja.

- Gjymtyra emërore e lokucioneve me parafjalën *me* mund të jetë një emër konkret, si: *me doreza* (fshehur), *me pëllëmbë* (mirë) etj. Emri e ka humbur kuptimin a kuptimet e tij dhe përdoret i ngurtësuar. Lokucioni ka kuptim të bartur dhe ka vlerën e një ndajfoljeje mënyre. P.sh. - *Atë vend e njoh me pëllëmbë, se atje jam rritur, - tha Demiri.*

• Parafjala *më* ka formuar lokucione, duke u lidhur me fjalë kuptimplota që janë kategori të ndryshme leksiko - gramatikore.

- Lokucionet *më së miri, më së bukuri më së qarti* (qartësisht) janë formuar nga parafjala *më* dhe një emër asnjës i prejardhur. Këto lokucione tregojnë mënyrë veprimi. P.sh. *Që banorët e Himarës... kanë shkuar kaq larg në prirjet e tyre helenistike, e provon më së miri, që ata kishin më shumë karakter se bashkëbesimtarët e tyre. Për mua baca Dan do të mbetet gjithmonë shkrintari që ka ditë t'i lexojë më së bukuri tregimet e tij.*

- Një grup lokucioneesh me parafjalën *më* në strukturë kanë element kryesor një ndajfolje me orgjinë nga numërorët, si: *më njësh, më dysh, më tresh, më katërsh* etj. P.sh. *Duke marrë të katërtin filxhan, që e hodhi më njësh, foli edhe Basho Gori. Ja, më në fund, dhe parmenda e tyre. / Ah, plugu i saj si na çante më dysh!*

---

merret si emër abstrakt (*Orgjina...*, art. i cit., f. 198). E. Hysa këta emra i quan mbiemra të substantivuar në formën e gjinisë asnjësore (*Formimi...*, art. i cit., f. 304). Të njëjtin qëndrim mban ky autor edhe në *Gramatika ...*, 1, vep. e cit., f. 380. Po në këtë vepër F. Agalliu i quan emra me “trajtën e mbiemrit asnjës të emëruar,” sepse në gjuhën e sotme “mbiemri i emëruar, siç dihet, nuk përdoret më” (f. 147). Sh. Demiraj i quan emra prejmbiemërorë të gjinisë asnjësore (*Rreth ndajfoljësimit ...*, art. i cit. f. 76).

Ndryshe nga parafjala *me*, kjo parafjalë te këto lokucione nuk është element i domosdoshëm dhe mund të mos përdoret, si: *së miri, së bukuri, njësh, dysh* etj. P.sh. *Trungjet e trasha i çanin dysh dhe me to ngarkonin kafshët.*

Në një numër të madh lokucionesh kjo parafjalë del si variant i parafjalës *në: më bisht, më gjunjë, më këmbë, më tym, më hënë, më të rrallë, më të djathtë* etj. dhe më rrallë i parafjalës *me: më nge*. P.sh. ***Më të djathtë*** kishte një shenjë që nga koha e fëmijërisë. Ai dëgjonte dhe, kur i dukej interesante, pyeste ***më nge*** për hollësitat.

• Parafjala *në* me një emër konkret apo abstrakt ka formuar lokucione që shprehin marrëdhënie të ndryshme kuptimore.

- Lokucionet *në të djathtë* (djathtas), *në të majtë* (majtas) etj. janë formuar nga parafjala *në* dhe një emër me orgjinë mbiemërore. Emri te këto struktura e ka humbur aftësinë për t'u lidhur me fjalët të tjera dhe funksionon së bashku me parafjalën. Këto lokucione shprehin marrëdhënie hapsinore. P.sh. ***Në të djathtë*** ishte selamllëku me një tarracë të madhe përpara, ***në të majtë***, mes pemëve, ngrihej ndërtesa shumë më e madhe e haremllekut.

- Lokucionet *në të errur, në të gdhirë* (herët), *në të kthyer, në të dalë, në të hyrë, në të ecur, në të gjallë* janë formuar nga parafjala *në* dhe një emër me orgjinë foljore. Emrat i kanë humbur veçoritë gramatikore dhe lidhjet me fjalët përcaktuese. Këto lokucione tregojnë kohë të pacaktuar, të pakufizuar të veprimit apo një moment kohor të shkurtër të kryerjes së tij: P.sh. ***Në të ngrysur*** u kthye në shtëpi bashkë me pendën e qeve. Duke gjurmuar për arin e dëshiruar, të cilit nuk po ia gjenin asgjëkund gjurmët, marinarët e Kolombit zbuluan duhanin, të cilit ***në të kthyer*** e sollën të parët në Evropë. - *T'u këndoftë kënga në të gjallë!*

- Një nëngrup më vete përbëjnë lokucionet me parafjalën *në* dhe një emër që emërton cak të shkurtër kohor, si: *në çast, në sekondë, në minutë, në moment* etj. Këto lokucione shprehin marrëdhënie kohore të përcaktuara. Sikurse ka ndodhur në përgjithësi te lokucionet e grupeve të mësipërme, edhe elementet përbërëse të këtyre strukturave janë ngurosur. Parafjala *në* nuk ruan asnjë nga kuptimet e saj të pavarura, ndërsa emrat janë ngurosur në formën e trajtës së pashquar. P.sh. *Bekimi, që e kishte pritur me kohë këtë pyetje, u përgjigj në çast.*

- Një grup lokucionesh të formuara nga parafjala *në* dhe një emër konkret apo abstrakt tregojnë mënyrën ose vendin e veprimit, si: *në këmbë* (këmbas), *në gjunjë* (gjunjas), *në krah, në hundë, në tym* (kot), *në hënë, në sy, në të thatë* (thatë) etj. Njësitë *në këmbë* (këmbas), *në krah, në hundë, në gjunjë* (gjunjas), *në hënë* kanë kuptim të drejtpërdrejtë. P.sh. ***Gjenerali mbeti në këmbë*** dhe asnjëri nuk ia përktheu fjalët e plakës Nicë, sepse njerëzit nuk e dinin se prifti dinte shqip. *Në të njëjtën kohë në skelën karshi filloi të kërcasë*

*një mitraloz. Antoni u shtri në krah dhe u mbështoll lëmsh, duke i kryqëzuar grushtet nën mjekër. Lokucionet në tym, në sy, në të thatë përdoren me kuptim të bartur. P.sh. Le t'ia përplaste çdo gjë në sy. Le të zemërohej miku nga qyteti. Nuk zë urimi në të thatë.*

Emrat në këto struktura janë ngurosur dhe funksionojnë vetëm brenda tyre.

- Me parafjalën *nën* dhe një emër janë formuar pak struktura me kuptim të figurshëm. Ato kanë vlerë ndajfoljore dhe gjatë përdorimit plotësojnë foljen e fjalisë. Të tilla janë: *nën zë, nën buzë, nën thua, nën dorë* etj. Këto njësi përdoren për të treguar mënyrë veprimi. P.sh. *Oborrtarët e pallatit e shikonin të mahnitur. Shumë prej tyre, nën zë, e quanin të çmendur. Ai qeshte nën buzë dhe nuk fliste.* Në FGJSSH strukturat *nën buzë, nën dorë, nën zë* janë dhënë si gjymtyrë të njësive frazeologjike për të treguar mënyrën se si kryhet një veprim.<sup>27</sup> J. Thomai në parathënien e fjalorit frazeologjik togjet *parafjalë + emër* i përfshin te jofrazeologjia.<sup>28</sup>

- Në pak struktura del parafjala *nëpër* e lidhur me një emër. Lokucioni ka kuptim të drejtpërdrejtë dhe përdoret me vlerën e një ndajfoljeje mënyre: *nëpër buzë, nëpër dhëmbë* (mbyturazi), *nëpër këmbë* etj. P.sh. *Ky nuk është një hap i thjeshtë, që mund ta hedhësh si të duash, majtas ose djathtas, duke fërshëllyer nëpër buzë një këngë. Ai var kryet e mermërit nëpër dhëmbë diçka që s'ia mora vesh, m'u duk sikur s'po ia nxirrte goja.*

- Lokucionet e formuara nga parafjala *pa* dhe një emër me orgjinë mbiemërore a një emër tjetër shprehin marrëdhënie të njëjta me lokucionet me parafjalën *me*, por në kuptim të kundërt. Edhe këto njësi tregojnë mënyrë a tipar të veprimit: *pa të drejtë* (padrejtësisht), *pa të keq* (çiltërsisht), *pa fre* (lirisht), *pa doreza* (drejtpërdrejt), *pa hesap, pa numër* (shumë) etj. P.sh. *Dafina i qe përgjigjur pa doreza. Në atë ndërtesë hynin e dilnin pa hesap njerëz të veshur me uniformë. - Tani s'kam pse rri më këtu... po kthehem në shtëpi. - Pse do të ikësh? - e pyeti shoqja pa të keq.*

c. Lokucione të formuara nga parafjalë të rasës rrjedhore dhe një emër. Parafjalët e kësaj rase që dalin si elemente të lokucioneve, janë të pakta. Më të përdorshme janë *prej, ndaj, para, prapa, pas*.

- Parafjala *prej* me një emër ka formuar lokucione që shprehin marrëdhënie semantike të ndryshme.

- Lokucionet *prej së largu, prej së afërmi, prej së tejmi* etj. janë formuar nga parafjala *prej* dhe një emër i prejardhur me orgjinë mbiemërore. Këto lokucione shërbejnë për të shprehur marrëdhënie hapsinore. Nuk kanë shkallë të lartë qëndrueshmërie të elementeve. Gjymtyra emërore përdoret edhe e vetme dhe shpreh marrëdhënie të njëjtë me lokucionin. P.sh. *Ai e dinte*

<sup>27</sup> Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980, f. 1231.

<sup>28</sup> J. Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, 1999, f. 12.

se ajo që dridhej në supet e djaloshit, ishte frika për të nesërmen, që po afrohej tani **prej së largu** nëpër gulshet e dendura të errësirës.

- Një grup lokucionesh me parafjalën *prej* kanë gjymtyrë emërore një emër kohe në rrjedhore shumë të pashquar. Të tilla janë: *prej kohësh*, *prej ditësh*, *prej vitesh*, *prej javësh* etj. Këto njësi shprehin marrëdhënie kohore të papërcaktuara. Elementet e tyre kanë lidhje qëndrueshmërie të ulët. Secili prej tyre e ruan kuptimin a një nga kuptimet leksikore. Emri mund të shoqërohet para ose pas me përcaktorë dhe parafjala tregon kohën kur nis një veprim. Si lokucione këto struktura funksionojnë kur kuptimi i tyre merr karakter përgjithësues, duke marrë vlerën e ndajfoljes *herët*.<sup>29</sup> P.sh. *Rrethanat evropianoqëndrore dhe evropianolindore janë të njohura prej kohësh*. Në këtë përdorim emri kohë nuk mund të përcaktohet nga përemrat *shumë*, *pak*, *ca*, *disa*, sepse kufiri kohor është mjaft i përcaktuar dhe i pakufizuar.

• Parafjalët me orgjinë ndajfoljore *para*, *prapa*, *pas* kanë formuar lokucione duke u lidhur me emra të ndryshëm konkretë dhe abstraktë.

- Lokucionet *pas qafe*, *prapa gardhit*, *prapa perdes* (fshehurazi), *pas pilafit* (shumë vonë) etj. janë formuar nga lidhja e parafjalës *prej* me një emër konkret. Kuptimi i këtyre lokucioneve është i figurshëm. Tregojnë kohën ose mënyrën e veprimit. P.sh. *Sigurisht që nuk gjetën gjë, se erdhën pas pilafit*.

- Këto parafjalë kanë formuar lokucione me kuptim të drejtpërdrejtë me një emër abstrakt kohe, si: *para kohe*, *pas kohe*, *para mesnate*, *pas mesnate* etj.<sup>30</sup> Këto lokucione shprehin marrëdhënie kohore. P.sh. *Nga gjithë shokët dhe bashkudhëtarët e Magelanit u kthyen vetëm 18 vetë, 18 skelete të gjalla, të zhveshura e të plakura para kohe, me ca këmisha thasësh të vjetër në trup*.

• Parafjala *ndaj* e lidhur me një emër abstrakt kohe në rrjedhore të pashquar ka formuar lokucione që tregojnë kohë të papërcaktuar: *ndaj të gdhiri*, *ndaj të erruri* (herët), *ndaj mesnate* etj. P.sh. *Ndaj të gdhiri qielli nisi të vishej me re*. Në ndonjë rast emri përdoret në kallëzore të pashquar. P. sh. *Ndaj të gdhirë, kur pa që edhe e motra rrinte zgjuar, ai u ngrit përgjysmë mbi dyshek dhe që andej i foli Vitës përkëtej, me zë të ulët që të mos dëgjonin gratë dhe fëmija*.

## 2. Lokucione të formuara nga një lidhëz dhe një fjalë kuptimplotë

Këto struktura do t'i sjellim në këtë shkrim më tepër për diskutim. Janë formuar me lidhëzën *sa* dhe një folje. Ato janë ndërtuar si pjesë të nënrenditura

<sup>29</sup> Një nga kuptimet e ndajfoljes *herët* në fjalor është “shumë kohë më parë”.

<sup>30</sup> Në Kongresin e Drejtshkrimit nuk është vendosur për shkrimin e këtyre strukturave, as si togje, as të njëfjalëzuara. Në FGJSSH *disa* prej tyre janë pasqyruar të njëfjalëzuara, ndërsa *disa*, meqë nuk janë njëfjalëzuar, nuk janë pasqyruar. Mendoj se të gjitha këto struktura janë njëfjalëzuar dhe duhen pasqyruar të tilla. Nuk vihet re asnjë dallim midis strukturës *paradite* dhe *para mesnate* as nga shqiptimi, as nga theksi, as nga përdorimi etj. Këto njësi përdoren në të njëjtën formë, si fjalë (ndajfolje).

të fjalive sasiore dhe funksionojnë si të tilla. Në përdorime të caktuara folja del në formë të ngurosur dhe jo me kuptimin e lidhore - dëshirores. Ajo merr kuptim përgjithësues dhe funksionon si gjymtyrë e një bashkimi të qëndrueshëm. Struktura të tilla tregojnë masën e veprimit a të tiparit: *sa të duash, sa të kërkosh* (shumë) etj. P.sh. *Mund të merrni edhe më tepër se atje ka sa të duash*. Këto struktura janë të diskutueshme, pasi në sintaksë me këtë regjim të foljes identifikohen fjalitë njëkryegjymtyrëshe me vetë të përgjithësuar. Elementi folje, në këto njësi, nuk e ka fituar plotësisht qëndrueshmërinë. Folja përdoret zakonisht në të tashmen, por ka edhe raste kur del në të pakryerën. Kur folja *dua* ruan kuptimin e lidhore - dëshirores, përdoret në forma të ndryshme: *sa të dojë, sa të doni, sa të duan* etj.

### 3. Lokucione të formuara nga një pjesëz dhe një fjalë kuptimplotë

Këtu do të sjellim lokucionin *më parë*, që është formuar nga pjesëza *më* dhe ndajfolja *parë*. Ndajfolja paraqitet si formë e ngurosur e ndajfoljes *para* (përpara). Pjesëza në këtë strukturë e ka humbur aftësinë për të formuar shkallën e ndajfoljes. Ndajfolja nuk përdoret në shkallë të ndryshme. Lokucioni shpreh marrëdhënie kohore të papërcaktuara. P.sh. *Kohët e fundit ai e kujtonte jo aq shpesh sa e kujtonte më parë atë shtëpinë e bukur të Apolelanit, e cila dukej si e rrethuar nga një lloj misteri*. Kuptimisht ky lokucin është i barazvlerëshëm me ndajfoljen *dikur*.

Nga parashtrimi i mësipërm mund të themi se për lokucionet në përgjithësi dhe për ato ndajfoljore në veçanti, megjithëse është shkruar, mbeten ende për të hulumtuar e trajtuar çështje të ndryshme që janë trajtuar pak ose aspak.

Numri i madh i lokucioneve ndajfoljore flet për larmishmërinë që paraqesin ato, qoftë me semantikën, qoftë me strukturën e tyre. Ky shkrim nuk ka trajtuar përfundimisht gjithë strukturat e këtyre lokucioneve, megjithatë ndihmon për njohjen më të plotë të këtyre strukturave nga pikëpamja e formimit të tyre. Trajtimi i këtyre lokucioneve, në çdo aspekt qoftë, kërkon një konceptim të qartë e të plotë të tyre, për të cilin, siç u theksua edhe më parë, edhe sot nuk ka qëndrim të njëjtë.

Para se këto lokucione të trajtohen e të analizohen në aspekte e këndvështrime të caktuara, ato duhen dalluar si të tilla mbi tiparet përcaktuese të tyre, të cilat i përjashtojnë nga njësitë a togjet e tjera të qëndrueshme. Gjithashtu, evidentimi dhe trajtimi i tyre është një kontribut, siç e ka nënvizuar më parë M. Domi,<sup>31</sup> për t'u dhënë vendin e duhur në gramatikat shkollore e ato shkencore, në veprat leksikografike, në mësimin e gjuhës shqipe në përgjithësi. Analiza strukturëformuese tregon se ato përbëjnë grupe e nëngrupe të shumta, të formuara nga pjesë të ndryshme të ligjëratës e të përdorura për të shprehur

<sup>31</sup> M. Domi, *Disa çështje ...*, art. i cit., f. 214.

marrëdhënie kuptimore të caktuara. Pavarësisht nga kategoria e fjalës si pjesë ligjërate, analiza e mësipërme tregon se, bazuar në marrëdhëniet e përgjithshme që shpreh ky grup lokucionesh (përgjithësisht rrethanore), në këto njësi vihen re paralelizma elementesh strukturore ose ngjashmëri në përdorimin e tyre. Në artikull është synuar që trajtimi të jetë sa më i hollësishëm, megjithatë mbetet për të shkruar në të ardhmen, sidomos për strukturat e formuara nga më shumë se dy fjalë.

## SUMMARY

### ADVERBIAL LOCUTIONS WITH TWO WORDS STRUCTURE

This article deals with the formation of locutions clause reflecting the semantic relationships that they express. At the introduction of this writing there is a brief description of the treatment of these locutions in some parts of Albanian grammar and its treatment in different articles of some researchers and the concept of locutions in general and adverbials in particular.

In the article are efforts to analyze the structural groups of these locutions, looking at different angles about their constituent elements, based on the material collected.

Taking as a criterion the number of words that make up their structure, adverbial locutions are grouped into two main groups with two word and multiword structure. This writing will deal with adverbial locutions with two word structure. They will be analyzed based on the lexicon - grammar category of the constituent words, based on the division: meaningful and non meaningful words.

I. The locutions formed by two meaningful words are few in number. Their structure consists of a pronoun and a name or a numeral and a name: *asnjë çast, asnjë moment, një çikë, një ditë* etc.

II. The locutions formed by a meaningful and non - meaningful word are numerous. The locutions according to the lexicon-grammar category of non-meaningful words are divided as it follows:

1. Locutions formed by a preposition and a meaningful word. The prepositions that are used in these locutions are in different cases. The prepositions of nominative case are rarely used, and the structures that have a preposition in accusative case are numerous. Even the locutions that have prepositions of ablative case are not numerous: *nga mot, me kohë, me të butë, më së miri, në të ngrysur, në hënë, nën zë, nëpër dhëmbë, pa të keq, për qiell, prej kohësh, ndaj mesnate* etc.

2. The locutions that have a connector are rare: *sa të duash*, *sa të kërkosh* etc.

3. The locutions that have a particle are rare *më parë* etj.

In conclusion, the analysis of these structures does not end with one or several items. The treatment of the locutions requires first of all a full clarity about the concept of locution in order to distinguish it from other colloquialisms. The evidence and the treatment of these linguistic units helps in a more effective way, reflecting it at different grammars even at different lexicographic works.

